



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
REKTORI

Nr. 584/1 Prot.

Tiranë, më 17.02 2023

V E N D I M

Nr. 53 datë 17.02 2023

**PËR**  
**SHPLLJEN E KONKURISIT PËR PRANIMIN E 1 (NJË) PUNONJËSI, PERSONEL**  
**AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË**  
**FIZIKE DHE REKREACIONIT PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË**  
**TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresën e Dekanit të FVFR me nr. 584/1 prot., datë 16.02.2023 "Përcjellje e kërkesës për personel akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit për vitin akademik 2022-2023", Rektori,

V E N D O S I :

Shpalljen në web-in <http://www.ust.edu.al> të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit si më poshtë :

**I. DEPARTAMENTI I AKTIVITETIT FIZIK REKREACIONIT DHE TURIZMIT**

- Organizimi i Qëndrave të Fitnesit "Bachelor" 1 (një) Lektor/Asistent Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për Lektor/Asistent Lektor, në modulën: **Organizimi i Qëndrave të Fitnesit, "Bachelor"** janë si më poshtë:

**Kritere të përgjithshme:**

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2. Kandidati që konkuron për pozicionin e punës "As/Lektor" duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të

- autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
3. Kandidati duhet të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave mbi 8 (tetë).
  4. Kandidati duhet të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
  5. Të mos ketë cënuar ose prishur imazhin e UST-së.
  6. Dëshmi Penaliteti/formular i vetëdeklarimit.

#### **Kritere specifike:**

1. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të ketë përvojë pune akademike, mësimdhënëse e kërkimore në fushën përkatëse në Institucionet e Arsimin të lartë.
3. Të ketë kryer aktivitete shkencore si : referime, botime brenda dhe jashtë vendit.
4. Vlerësohen kualifikimet dhe trajnimet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës.

#### **Kritere preferenciale:**

1. Kanë preferencë kandidatët që kanë kryer kualifikime kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat e organizimit të aktivitetit fizik, fitnesit dhe shëndetit.

## **II. Kandidatët që do të aplikojnë për këtë vend pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:**

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon;
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriteve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues);
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

## **III. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit**

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriteve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti dhe Departamenti ku konkuron.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

#### **IV. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët**

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.

V. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.

VI. Deri në datën 27.02.2023, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 01.03.2023 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.

VII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.

VIII. Dekanati i FVFR, përcjell listën përfundimtare brenda datës 03.03.2023, për miratim në Rektorat.

IX. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Administratori, Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FVFR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *web-in* <http://www.ust.edu.al>.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORI**

**Prof. Dr. Agron KASA**

